

## Vendim nr. 118 datë 30.05.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Sandër Beci,	Anëtar
Illir Toska,	Anëtar

në datën 30.05.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 2 (G) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** GANI IBRALIU, përfaqësuar nga avokat Mehmet Kurti, me prokurë të posaçme.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 4705, datë 14.04.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 1135, datë 13.05.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2023-2668, datë 21.06.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, pika 1, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 28, 29, 30, 39, 42 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Shtetasi L.B. rezulton pronar i pasurisë së paluajtshme tokë arë me sipërfaqe 7300 m<sup>2</sup>, të ndodhur në fshatin Koçaj, Baldushk, Tiranë. Ky shtetas për këtë pronë është pajisur me aktin e marrjes së tokës në pronësi, si dhe ka bërë regjistrimin e saj në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë. Lidhur me këtë pronë, shtetasi L.B. ka paditur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë shtetasin që e posedonte këtë pasuri, Gani Ibraliu (*kërkuesi*), duke kërkuar me padi rivendikimi kthimin e sendit.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 4705, datë 14.04.2014, ka vendosur pranimin e kërkesëpadsisë dhe detyrimin e kërkuesit t'i lirojë dhe dorëzojë paditësit L.B. sendin pasuri e paluajtshme në pronësi të këtij të fundit. Në vendimin e saj gjykata ka argumentuar se nga hetimi gjyqësor rezulton se paditësi provohet të jetë pronar i ligjshëm i pasurisë objekt gjykimi dhe se ai është zhveshur nga posedimi i pronës së tij në mënyrë të paligjshme nga kërkuesi. Ndaj këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi, duke kërkuar ndryshimin e tij dhe rrëzimin e padsisë.

3. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1135, datë 13.05.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke e vlerësuar të drejtë atë, ndërkohë që shkaqet e parashtruara në ankim nga kërkuesi janë konsideruar të pabazuara në ligj dhe në prova. Ndaj këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë duke kërkuar prishjen e vendimeve të gjykatave të faktit dhe kthimin e çështjes për rigjykim.

4. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 00-2023-2668, datë 21.06.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (*KPC*).

5. Në datën 27.03.2024 (sipas shërbimit postar) kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 09.04.2024.

### II

#### Pretendimet e kërkuesit

6. *Kërkuesi*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se gjatë procesit gjyqësor të kundërshtuar i është cenuar:

6.1. *E drejta për proces të rregullt*, në drejtim të:

- 6.1.1. *Së drejtës së aksesit në gjykatë* të lidhur me *të drejtën për t'u njoftuar*, pasi njoftimi i gjykatës së apelit është i pavlefshëm, sepse është kryer në kundërshtim me rregullat e KPC-së. Për këtë shkak kërkuessit i është mohuar aksesit në gjykatë.
- 6.1.2. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit dhe atij të sigurisë juridike*, pasi kërkuessit nuk është njoftuar për gjykimin e çështjes në gjykatën e apelit, duke i mohuar të drejtën për t'u dëgjuar dhe për të paraqitur prova shtesë.
- 6.1.3. *Parimit të paanshmërisë*, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në faqen 5 të vendimit shprehet se pala e paditur ka vlerësuar ta lërë në mungesë gjykimin, në një kohë kur ajo nuk ka pasur njoftim për gjykimin në gjykatën e apelit, duke treguar njëanshmëri të plotë. Ky fakt nuk qëndron, pasi kërkuessit nuk është njoftuar për seancën gjyqësore të zhvilluar në gjykatën e apelit të datës 13.05.2015.
- 6.1.4. *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs.
- 6.2. *E drejta e pronës private*, për shkak se kërkuessit, në cilësinë e pronarit të vjetër, është vënë në posedim të pasurisë tokë arë prej vitit 1991, duke e poseduar atë për 33 vjet, ndërkohë që paditësi e ka fituar pronësinë mbi këtë pasuri në kundërshtim me ligjin dhe mbi dokumente të falsifikuara, çka nuk është mbajtur parasysh nga gjykatat.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkuessit

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet

e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kritere paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht, për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

8. Kolegji çmos se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës , të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

9. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji konstaton se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

10. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Gjykata ka theksuar se vënia në dispozicion të palëve e vendimeve të gjykatës ua bën të njohura atyre arsyet e vendimmarrjes, duke u dhënë mundësinë të ankohen nëse e shohin të arsyeshme. Për rrjedhojë, si datë e fillimit të afatit ligjor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, që i korrespondon momentit të konstatimit të cenimit, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, është data e marrjes dijene efektivisht për vendimin gjyqësor të marrë në ushtrim të mjetit të fundit ankimor. Si rregull, kjo datë është ajo e shpalljes së vendimit gjyqësor të arsyetuar në prani të palës, kurse kur vendimi gjyqësor nuk shpallet i arsyetuar ose kur pala nuk është e pranishme, data e marrjes dijene konsiderohet ajo e njoftimit shkresor ose elektronik të tij. Në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijene konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin konkret, Kolegji vëren se vendimi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi, ai i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, mban datën 21.06.2023, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë më 27.03.2024. Për qëllime të këtij shqyrtimi i është kërkuar informacion Gjykatës

së Lartë në lidhje me momentin në të cilin ky vendim është bërë i disponueshëm për palët. Me informacionin e datës 23.04.2024, Gjykata e Lartë ka sqaruar se vendimi i saj nr. 00-2023-2668, datë 21.06.2023 është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 19.10.2023, datë nga e cila është bërë i disponueshëm për palët. Ndërkohë nga ana e kërkuetit, në ankimin kushtetues individual pretendohet se ai është njohur me vendimin e arsyetuar të Gjykatës së Lartë në datën 13.03.2024, pa dhënë argumente të tjera në lidhje me mënyrën në të cilën ka marrë dijeni për këtë vendim dhe se e ka depozituar ankimin kushtetues individual brenda afatit ligjor 4-mujor.

12. Në lidhje me këtë kriter, me vendimin e ndërmjetëm të datës 09.05.2024, Kolegji ka vendosur kthimin e akteve kërkuetit për plotësim, me qëllim paraqitjen e argumenteve dhe provave lidhur me respektimin e afatit ligjor 4-mujor të paraqitjes së ankimit kushtetues individual, duke mbajtur në konsideratë se vendimi nr. 00-2023-2668, datë 21.06.2023 i Gjykatës së Lartë është bërë publik dhe i disponueshëm për palët, përfshirë edhe për kërkuetin, në datën 19.10.2023. Në përgjigjen e tij të datës 27.05.2024 kërkueti ka parashtruar se ai është interesuar në sekretarinë e Gjykatës së Lartë në datën 13.03.2024 dhe në këtë datë ka marrë dijeni për vendimmarrjen e saj, ndërkohë që vendimi i arsyetuar i asaj gjykate i është vënë në dispozicion në datën 13.04.2024. Sipas kërkuetit, ai nuk ka pasur dijeni më parë, ndërsa nuk ka asnjë njoftim tjetër.

13. Në kontekstin e këtyre rrethanave, parashtrimet e kërkuetit se është njohur me vendimin e Gjykatës së Lartë kur është interesuar për të marrë informacion pranë sekretarisë gjyqësore të saj, në kushtet kur ai nuk ka paraqitur ndonjë argument ose provë për pamundësinë e marrjes dijeni, nga vetë ai ose mbrojtësi i zgjedhur prej tij, për vendimin e arsyetuar nga momenti kur ka qenë i disponueshëm për palët, nuk është i mjaftueshëm për të provuar në nivel kushtetues se kjo është data e marrjes dijeni për vendimin e kundërshtuar, për sa kohë është në të drejtën e palës në proces për të kërkuar dhe tërhequr në çdo moment pranë sekretarisë së gjykatës kopje të vendimit gjyqësor.

14. Nga sa më lart, duke analizuar argumentet e paraqitura nga kërkueti në raport me standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese, Kolegji çmon se kërkueti nuk ka arritur të provojë në nivel kushtetues se ka marrë dijeni në një datë të ndryshme nga data në të cilën vendimi i Gjykatës së Lartë është bërë i disponueshëm për palët. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual është paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000.

15. Në kushtet kur kriteri paraprak për legjitimitimin *ratione temporis* nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterit *ratione materiae* bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

16. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

**PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.